



## **RAPORT VLERËSIMI I CAO-s**

**Për ankesën e dytë në lidhje me  
investimin e IFC-së për projektin e Enso (#30979) në Shqipëri**

Shtator 2019

Zyra e Auditit, Këshilltarit dhe Avokatit të Popullit  
*për*  
Korporatën Financiare Ndërkombëtare dhe  
Agjencinë për Garancinë e Investimeve Shumëpalëshe  
[www.cao-ombudsman.org](http://www.cao-ombudsman.org)

## Rreth CAO-s

Zyra e Auditit, Këshilltarit dhe Avokatit të Popullit (CAO)<sup>1</sup> është mekanizmi i pavarur i përgjegjshmërisë për Korporatën Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe Agjencinë për Garancinë e Investimeve Shumëpalëshe (MIGA), degë të sektorit privat të Grupit të Bankës Botërore. CAO raporton drejtpërdrejt te Presidenti i Grupit të Bankës Botërore dhe mandati i Zyrës është të ndihmojë në trajtimin në mënyrë të drejtë, objektive dhe konstruktive të ankesave të bëra nga njerëz të prekur nga projektet e financuara nga IFC/MIGA dhe të përmirësojë rezultatet shoqërore dhe mjedisore të këtyre projekteve.

Për më shumë informacion, shikoni faqen e internetit [www.cao-ombudsman.org](http://www.cao-ombudsman.org).

---

<sup>1</sup> Akronimet janë lënë në gjuhën angleze, pasi kështu njihen në literaturën financiare.

## TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E AKRONIMEVE .....	4
1. HYRJE .....	
<b>Error! Bookmark not defined.</b>	
2. KONTEKSTI .....	
<b>Error! Bookmark not defined.</b>	
2.1 Projekti .....	5
2.2 Ankesa .....	5
3. PËRMBLDHJE E VLERËSIMIT .....	5
3.1 Metodologjia .....	5
3.2 Përmbledhje e këndvështrimeve .....	6
4. HAPAT E MËTEJSHËM .....	9
SHTOJCA A. PROCESI I TRAJTIMIT TË ANKESAVE NGA CAO .....	10

## LISTA E AKRONIMEVE

CAO	Zyra e Auditit, Këshilltarit dhe Avokatit të Popullit
ESIA	Raporti i Vlerësimit të Ndikimit Social dhe Mjedisor
IFC	Korporata Financiare Ndërkombëtare

## **1. HYRJJE**

Në mars 2019 CAO mori një ankesë nga anëtarë të komunitetit që jetojnë në qytetin e Klosit dhe në fshatrat përreth, respektivisht Klos-Katund, Fshat, Benjë, Fullqet, Dars, Bershi dhe Pleshë ('Ankuesit'). Në ankesë ngrihen shqetësime që lidhen me ndikime të mundshme mjedisore dhe sociale të Projektit të Hidrocentraleve mbi Lumin Mat. Projekti është i kompanisë Enso ("Kompania"), një klient i IFC-së. Zbatimi i projektit nuk ka filluar ende. CAO doli me përfundimin që ankesa i plotëson tri kriteret e pranueshmërisë dhe bëri një vlerësim, i cili u përmbyll me vendimin e ankuesve, për ta referuar rastin të funksioni i auditit i CAO-s për një vlerësim të rolit të IFC-së.

## **2. KONTEKSTI**

### **2.1 Projekti**

Sipas informacionit publik në faqen e internetit të IFC-së, IFC-ja zotëron një investim prej 8.6 milion dollarësh në një kompani aksionere në Shqipëri të themeluar nga Enso Hydro, një kompani austriake e specializuar në investimet e vogla dhe të mesme në hidrocentrale. Një nga projektet e hidrocentraleve që ka investuar kompania është projekti Mati Hydro, një koncesion për ndërtimin e disa hidrocentraleve të vogla në rrjedhën e Lumit Mat (të quajtur Mati 1, Mati 2 dhe Mati 3), në rrethin e Matit, Shqipëri ("Projekti"), me një kapacitet total prej 38 MV. Sipas IFC-së, kompania ende nuk ka filluar ndërtimin në terren. Gjithashtu, IFC-ja shpjegon se janë përgatitur vetëm disa dokumente teknike në lidhje me projektin dhe se Enso duhet të përgatisë dhe të bëjë publik raportin e vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe social.

### **2.2 Ankesa**

Ankesa u bë nga ankuesit me mbështetjen e një specialisti mjedisor vendas. Ankesa ngre shqetësime në lidhje me mungesën e ujit, ndikimin në bujqësi dhe zhvillimin rural, si dhe mungesën e konsultimit të duhur dhe zhvillimit të komunitetit. Më shumë informacion për ankesën gjendet në vijim të raportit.

## **3. PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT**

### **3.1 Metodologjia**

Qëllimi i vlerësimit është për të kuptuar më mirë çështjet dhe shqetësimet e ngritura nga ankuesit përmes marrjes së informacionit nga palë të ndryshme, pa gjykuar nëse ankesa qëndron apo jo. Gjithashtu, vlerësimi kërkon të përcaktojë se cilin funksion të CAO-s duan të ndjekin palët – procesin e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve apo funksionin e Auditit (shiko Aneksin A për procesin të trajtimit të ankesave nga CAO).

Në këtë rast, procesi i vlerësimit konsistoi në:

- shqyrtimin e dokumentacionit të projektit;
- biseda telefonike dhe takime në Shqipëri me ankuesit dhe specialistin mjedisor që i mbështet ata;
- biseda telefonike dhe takime me përfaqësues të Enso-s;
- biseda telefonike me grupin e projektit të IFC-së;
- takim me kryetarin e Bashkisë Klos;
- takim me disa përfaqësues të OJF-ve mjedisore në Tiranë.

Ky dokument përmbledh këndvështrimet e shprehura nga palët për grupin e CAO-s dhe përshkruan hapat e mëtejshëm, bazuar në vendimet e marra nga ankuesit dhe kompania.

## **3.2 Përmbledhje e këndvështrimeve**

### **3.2.1 Këndvështrimi i ankuesve**

Grupi i CAO-s takoi rreth 23 përfaqësues të ankuesve. Shqetësimet e ankuesve të shprehura gjatë procesit të vlerësimit janë përmbledhur në tri kategori:

- a) mungesa e ujit;
- b) moskonsultimi publik me komunitetin e prekur nga projekti; dhe
- c) mungesa e projekteve të zhvillimit për komunitetin.

#### **a) Mungesa e ujit**

Ankuesit pretendojnë se Enso po planifikon të ndërtojë një projekt hidro në rrjedhën e lumit Mat, në Bashkinë e Klosit, dhe se projekti do të ketë tre seksione të lokalizuara në tri pika të ndryshme, të quajtura Mati 1, Mati 2 dhe Mati 3. Sipas mënyrës që e kishin kuptuar ata, projekti ishte hartuar që në secilin hidrocentral të kishte një rezervuar uji dhe një digë të vogël, pikë në të cilën uji do të devjiohej në një tunel dhe do të kthehej prapë në lumë.

Ankuesit ndanë shqetësimin se lumi do të thahej për shkak të sasisë së ujit që do të devjiohej në tunele. Ata kishin dëgjuar se kompania po planifikon të lejojë një 'rrjedhë ekologjike' në lumë – që do të thotë – një sasi të caktuar të ujit në lumë – por janë të shqetësuar që kjo sasi është e pamjaftueshme. Ata kanë frikë se gjatë sezonit të thatë të verës, kur atyre u nevojitet uji më shumë, lumi do të thahet plotësisht në ato pjesë. Ata tregojnë se kjo ka ndodhur në vende të tjera me projektet e hidrocentraleve. Sipas ankuesve, pakësimi i nivelit të ujit të lumit do të ketë një ndikim negativ në eko-sistemin e lumit dhe do të shkaktojë zhdukjen e peshqve dhe të faunës së lumit. Ata besojnë se ndërtimi i hidrocentraleve do t'i pengojë për vaditjen e prodhimeve bujqësore, si dhe për sigurimin e ujit për bagëtitë e tyre. Ata shtojnë se, me ndryshimin e klimës, mund të ketë episode të thatësirave gjatë stinës së verës, dhe shprehin nevojë për të pasur ujë të mjaftueshëm për prodhimet e tyre gjatë gjithë vitit, dhe jo vetëm gjatë stinës së thatë, si dhe shprehin frikën se ndërtimi i projektit do t'i lërë pa ujë.

Ankuesit shprehën shqetësimin e tyre për tunelin e Matit 2, për të cilin ata thonë se do të përshkojë 7 kilometra nën fshatin Fullqet, dhe se do të thajë pusët e ujit në atë fshat. Ata pretendojnë se është një precedent i një rasti të tillë në zonë. Ata përmendën rastin e traverbankut në fshatin Plan i Bardhë, i cili u ndërtua për minierën e kromit në Bulqizë. Ata pretendojnë se, si rezultat i atij traverbanku, i gjithë fshati i Planit të Bardhë ishte privuar nga uji dhe banorët ishin detyruar të zhvendoseshin në zona të tjera.

Gjithashtu, ankuesit shprehën shqetësime në lidhje me rezervuarët, të cilët, sipas tyre, do të ndërtohen në secilën nga pikat e marrjes së ujit të projektit (Mati 1, Mati 2 dhe Mati 3). Ata pretendojnë se, siç ka ndodhur në vende të tjera, si p.sh., në Ulëz, prania e rezervuarit krijon mjegull në mëngjes dhe rrit nivelin e lagështirës, e cila ka një ndikim negativ në bimët e mbjella afër rezervuarit. Ata gjithashtu pretendojnë se mbetjet dhe zhavorri, në vend që të dërgohen në det përmes lumit, do të akumulohen në rezervuar. Ankuesit mendojnë se akumulimi i mbetjeve dhe i zhavorrit në lumë do të bëjë që uji të dalë mbi nivelin e digës dhe të shkaktojë përmytje në zonë.

Në përfundim, ankuesit pretendojnë se janë shtatë projekte hidrocentralesh në zonën e Klosit, mbi lumin Mat (disa janë vënë në punë, të tjerët në ndërtim e sipër), dhe se janë të shqetësuar për ndikimet e mundshme të këtyre projekteve së marra së bashku.

#### **b) Moskonsultimi i duhur me anëtarët e komunitetit të prekur**

Ankuesit shprehin se ata nuk janë kundër investimeve në zonë, për sa kohë që projektet e investimeve bëhen në konsultim me komunitetin. Ata mendojnë se, në rastin e Projektit Mati, nuk janë bërë konsultimet e duhura.

Ankuesit tregojnë se kishin marrë pak informacione rreth projektit para dhe gjatë vitit 2016, por kompania nuk u kishte dhënë detaje rreth komponentëve të ndryshëm të projektit dhe pë ndikimin specifik të secilit komponent. Ata shprehen se kur kompania shkoi të zhvillonte konsultime publike në Bashkinë Klos në dhjetor 2016, banorët organizuan një protestë të madhe, e cila përfundimisht e pengoi Kompaninë që të zhvillonte takimin.

Ankuesit pretendojnë se kanë dëgjuar gjithashtu për takime të mbyllura të organizuara nga kompania dhe janë të shqetësuar nëse konsultimet bëhen në mënyrë të fshehtë dhe vetëm me disa njerëz. Disa ankues tregojnë se ata kanë marrë pjesë në takime ku kompania ka qarkulluar një listë pjesëmarrjeje dhe më vonë ka pretenduar se firmat në fletën e pjesëmarrjes janë konsideruar se pjesëmarrësit kanë qenë dakord me projektin.

Ankuesit shtojnë se ata nuk kanë informacion për statusin aktual të projektit, dhe se nuk kanë ndonjë informacion nga kompania që prej vitit 2016. Ata shprehën pakëngësi për faktin që kompania nuk i ka përditësuar me informacion dhe se nuk është transparente në komunikim e saj me banorët.

Ankuesit pretendojnë se kompania nuk ka e ndarë me ta raportin e vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe social (ESIA) të Projektit. Ata gjithashtu shprehen se, gjatë komunikimit të tyre të kufizuara me kompaninë, kjo e fundit është fokusuar në demonstrimin vetëm të ndikimeve pozitive të projektit, dhe nuk ka ndarë asnjë informacion në lidhje me ndikimet e mundshme negative. Ankuesit pretendojnë se do të donin të kishin më shumë informacion në lidhje me projektin, statusin e tij dhe detyrimin e kompanisë sipas kontratës së koncesionit.

### **c) Mungesa e projekteve të zhvillimit për komunitetin**

Ankuesit pretendojnë se investimet në zonë - siç është Projekti - përdorin burimet e zonës dhe se do të ishte e drejtë që ato investime të kontribuonin gjithashtu dhe për zhvillimin e zonës. Sipas ankuesve, hidrocentralet që funksionojnë tashmë në zonën rreth Klosit i shërbejnë vetëm interesave ekonomike të kompanive që i zotërojnë dhe nuk kanë kontribuar në zhvillimin e mëtejshëm të komunitetit. Për më tepër, ankuesit sqarojnë se shumica e punëtorëve që punojnë në ato projekte vijnë nga Tirana, dhe nuk punësohen nga zona.

Gjithashtu, ata pretendojnë se Enso kishte premtuar të ndërtonte rrugë, por ndërtimi nuk ka filluar ende.

Në përfundim, ankuesit theksuan se ishin kundër projektit dhe se qëllimi i tyre ishte të bllokoni ndërtimin e tij. Ata shtuan se nuk janë të interesuar të komunikojnë me kompaninë.

### **3.2.2 Këndvështrimi i kompanisë**

Kompania u shpreh se licenca për projektin iu është dhënë në vitin 2012. Ata pretendojnë se për të vlerësuar fizibilitetin e projektit dhe për të vendosur për hartimin e projektit ishin konsultuar me Bashkinë Klos dhe me anëtarët e komunitetit nga viti 2013 deri në 2016-ën, dhe se kishin kryer studime të ndryshme hidrologjike dhe gjeologjike.

Kompania shpjegoi se për hidrocentralin Mati 1 uji do të merret në rrjedhën e sipërme të Urës së Vashës. Uji do të devijohet në një tunel prej 2.6 kilometrash të gjatë dhe më pas në një tubacion<sup>2</sup> të shkurtër të vendosur një metër nën tokë deri te centrali elektrik, ku uji do të kthehet përsëri në lumë. Uji për hidrocentralin Mati 2 do të merret pikërisht në rrjedhën e poshtme të urës së Fullqetit në Klos. Uji do të shmanget në një tunel prej 9.5 kilometrash të gjatë dhe më pas në një tubacion të shkurtër deri te centrali elektrik, ku dhe uji do të kthehet përsëri në lumë. Uji për hidrocentralin Mati 3 do të merret në rrjedhën e poshtme të lumit në fshatin e Gurit të

---

<sup>2</sup> Sipas kompanisë, dallimi midis një tuneli dhe tubacioni është se në tunel nuk ushtrohet presioni i ajrit, ndërsa te tubacioni po.

Bardhë. Enso përpiqet të respektojë kërkesat e Standardit 5 të Performancës së IFC-së për përdorimin e tokës që nevojitet.

Enso shpjegoi se ndërtimi i projektit ende nuk ka filluar, për shkak të disa projekteve konkurruese që rrezikojnë fizibilitetin dhe qëndrueshmërinë e tij. Kompania shtoi se kanë qenë në kontakt me autoritetin kontraktues për të zgjidhur të gjitha çështjet e hapura që mund të ndikojnë te koncesioni dhe në investimet e mëtejshme.

Më tej kompania vazhdoi me adresimin e shqetësimeve specifike të ngritura nga ankuesit.

#### **a) Mungesa e ujit**

Për çështjen e nivelit të ujit në lumë, kompania sqaroi se projekti është hartuar duke siguruar që gjatë gjithë kohës të mbetet sasi e mjaftueshme uji në lumë. Uji që do të mbetet në lumë quhet "rrjedhë ekologjike". Kjo rrjedhë mund të ndryshojë në varësi të stinës, por kompania pretendon se rrjedha ekologjike do të jetë gjithmonë e mjaftueshme për të ruajtur ekosistemin e lumit dhe për nevojat e komunitetit. Një sistem i instaluar do të masë nivelin e ujit të disponueshëm në lumë gjatë gjithë kohës, dhe në rastet kur niveli është i ulët (për shembull gjatë stinës së thatë), sistemi është projektuar në mënyrë të tillë që të ndalojë devijimin e ujit dhe për ta lënë të gjithë ujin e disponueshëm të rrjedhë në lumë.

Për çështjen e puseve në Fullqet, kompania sqaroi se kishin qenë në Fullqet me një hidrolog dhe kishin bërë matjet e të gjitha puseve. Ata gjithashtu kishin kryer studime që tregojnë se, ndërtimi i tuneleve të Matit 2 nën fshatin Fullqet, nuk do të ketë ndonjë ndikim në sasinë e ujit të disponueshëm në puse. Kjo për shkak se puset janë puse sipërfaqësore dhe nuk përdorin ujin nëntokësor, dhe gjithashtu sepse tuneli do të ndërtohet 100 metra nën sipërfaqe dhe do të jetë prej betoni, i cili nuk është poroz.

Lidhur me çështjen e mjegullës, kompania sqaroi se projekti nuk përfshin ndërtimin e rezervuarëve të vërtetë të krahasueshëm me atë të Ulzës. Në pikën e marrjen së ujit për secilin hidrocentral, do të jetë një pellg ujqor i vogël dhe do të ndërtohet një digë katër metra e lartë. Një pellg i tillë i vogël nuk do të ketë ndonjë ndikim në lagështinë e ajrit dhe nuk do të krijojë mjegull. Kompania shpjegoi se fillimisht ata kishin shqyrtuar mundësinë e një dige të madhe, por projekti ishte ndryshuar, sepse komuniteti ishte kundër ndërtimit të një rezervuari të madh dhe një dige të lartë.

Kompania shpjegoi se kishin bërë një analizë gjithëpërfshirëse për përmbajtjet, për t'u siguruar që pellgjet të projektohen në mënyrë të tillë që të mos dalin nga shtrati edhe në rast përmbajtjeje. Teknikisht, niveli i ujit në pellg duhet të mbetet i njëjtë që sistemi të funksionojë siç duhet. Për t'u siguruar që niveli në pellg të mbetet i njëjtë, valvulat e instaluar në digën e vogël do të hapen nëse ka më shumë ujë.

Sa i përket mbetjeve dhe zhavorrit, kompania shpjegoi se ekzistonte një sistem për t'i shpërndarë në rast se ato grumbullohen në pellgje.

Në përgjithësi, kompania i shpjegoi CAO-s se projekti ishte hartuar duke marrë parasysh puset dhe urat ekzistuese, peshqit, burimet ujore dhe florën, dhe duke minimizuar ndikimin e tij në komunitet dhe natyrë, duke shmangur pyjet dhe tokën bujqësore sa më shumë që të jetë e mundur. Projekti përfshin ndërtimin e kalimeve për peshqit, të cilat janë projektuar për të lejuar migrimin e peshkut.

#### **b) Moskonsultimi i duhur me anëtarët e komunitetit të prekur**

Kompania pretendon se, që në kohën kur iu dha koncesioni në vitin 2012, ata kanë qenë në kontakt me Bashkinë e Klosit. Ata pretendojnë se janë konsultuar me anëtarë të komunitetit gjatë hartimit të Projektit dhe se kanë marrë parasysh reflektimet e tyre. Sipas kompanisë, janë shpërndarë fletëpalosje me informacione rreth projektit në Klos dhe në fshatrat përreth.



Ata gjithashtu shpjeguan se nuk kanë qenë në komunikim me anëtarët e komunitetit në lidhje me projektin që nga viti 2017, pasi projekti ishte ndërprerë, dhe se deri tani ndërtimi i tij është ende i pasigurt. Ata shtojnë se planifikojnë të vendosin përsëri komunikim me anëtarët e komunitetit të Bashkisë Klos sapo të jenë më të qartë për të ardhmen e projektit.

### **c) Mungesa e projekteve të zhvillimit për komunitetin**

Kompania shpjegoi se projekti do të ketë një ndikim pozitiv në zhvillimin e komunitetit. Zbatimi i projektit do të zgjasë afërsisht tre vjet. Njerëzit që punojnë për projektin do të kenë nevojë për ushqim dhe akomodim, dhe nga kjo do të përfitojnë hotelet, restorantet dhe qiradhënësit, që duan të japin me qira pronat e tyre.

Kompania sqaroi se ata kanë diskutuar me anëtarë të komunitetit për disa projekte të zhvillimit për komunitetin. Këto projekte nuk kanë filluar akoma, sepse kompania nuk është ende e sigurt nëse do të ndërtohet projekti dhe kur. Kompania përmendi, për shembull, që komuniteti i fshatrave Shkallë dhe Fshat kishte shprehur nevojën për një sistem më të mirë vadijeje për të mbjellat e tyre. Kompania u kishte thënë anëtarëve të komunitetit se do të ishin dakord të instalonin tubacione për ta transportuar ujin nga pika e marrjes së ujit për Matin 3 në fshatin e tyre. Kompania gjithashtu përmendi që, nëse projekti do të fillonte zbatimin, ata do të merrnin në konsideratë mbështetjen për banorët duke ofruar kurse të gjuhës angleze dhe duke përmirësuar shkollat dhe rrugët.

Kompania sqaroi se ata do të merrnin përsipër që gjatë periudhës së ndërtimit, 30% e forcës së tyre të punës të ishin banorë vendas, dhe se gjithashtu do të përpiqeshin të punësonin banorë vendas edhe gjatë periudhës së funksionimit të hidrocentraleve.

Në përgjithësi, kompania theksoi se ata ishin të hapur për të marrë pjesë në takime me anëtarë të komunitetit dhe për të komunikuar me ta.

## **4. HAPAT E MËTEJSHËM**

Gjatë procesit të vlerësimit të CAO-s, ankuesit shprehën preferencën e tyre që ankesa t'i referohet funksionit të auditit të CAO-s. Prandaj, duke pasur parasysh natyrën vullnetare të pranimit ose jo të procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, dhe në përputhje me udhëzimet operacionale të CAO-s, ankesa do t'i referohet funksionit të auditit të CAO-s për vlerësimin e performancës së IFC-së në lidhje me projektin.

## SHTOJCA A. PROCESI I TRAJTIMIT TË ANKESAVE NGA CAO

Në momentin kur CAO vendos se ankesa është e pranueshme, specialistët e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të CAO-s bëjnë një vlerësim fillestar. Qëllimi i vlerësimit nga CAO është: (1) të qartësojë çështjet dhe shqetësimet e ngritura nga ankuesi (it); (2) të mbledhë informacion se si e perceptojnë situatën aktorët e tjerë; dhe (3) të ndihmojë palët e interesit të kuptojnë mundësitë e disponueshme për t'i mbështetur ata dhe të përcaktojnë nëse ata dëshirojnë të ndjekin një proces për zgjidhje bashkëpunuese përmes funksionit të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të CAO-s, ose nëse çështja duhet të shqyrtohet nga funksioni i auditit i CAO-s.

Sipas Udhëzimeve Operacionale të CAO-s<sup>3</sup>, zakonisht ndiqen hapat e mëposhtëm si përgjigje ndaj një ankese që është marrë nga CAO:

Hapi 1: **Konfirmimi** i marrjes së ankesës.

Hapi 2: **Pranueshmëria**: Përcaktimi që ankesa i përmbush kriteret për vlerësim nën mandatin e CAO-s (jo më shumë se 15 ditë pune).

Hapi 3: **Vlerësimi nga CAO**: Vlerësimi i çështjeve dhe ofrimi i mbështetjes për palët e interesuara për të kuptuar dhe përcaktuar nëse ato preferojnë të ndjekin një zgjidhje konsensuale përmes një procesi bashkëpunues të drejtuar nga funksioni i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të CAO-s, ose nëse çështja duhet të trajtohet nga funksioni i auditit i CAO-s për të rishikuar kujdesin e treguar nga IFC/MIGA për respektimin e standardeve sociale dhe mjedisore. Vlerësimi duhet të kryhet në një kohë jo më shumë se 120 ditë pune.

Hapi 4: **Ndërmjetësimi i zgjidhjes**: Nëse palët zgjedhin të ndjekin një proces bashkëpunues, vihet në lëvizje funksioni i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve i CAO-s. Procesi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve bazohet zakonisht ose fillon me një Memorandum Mirëkuptimi dhe/ose rregullash të dakortësuara midis palëve. Procesi mund të përfshijë lehtësimin/ndërmjetësimin, gjetjen bashkërisht të fakteve, ose mënyra të tjera zgjidhjeje që çojnë në një marrëveshje për zgjidhjen ose në arritjen e qëllime të tjera të dakordësuara dhe të përshtatshme për palët. Qëllimi kryesor i këtyre qasjeve për zgjidhjen e problemeve është që të adresohen çështjet e ngritura në ankesë, dhe çështje të tjera të rëndësishme që lidhen me ankesën dhe që janë identifikuar gjatë vlerësimit ose procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, në një mënyrë që të jetë e pranueshme për palët e prekura.<sup>4</sup>

OSE

**Vlerësimi për Audit/Hetimi**: Nëse palët zgjedhin procesin e auditit, funksioni i auditit i CAO-s do të ndërmarrë një vlerësim për të parë nëse IFC/MIGA kanë treguar kujdesin e duhur social dhe mjedisor për projektin në fjalë, për të vendosur nëse duhet të bëhet një hetim në lidhje me performancën e IFC/MIGA-s në lidhje me projektin. Koha e vlerësimit mund të zgjasë jo më shumë se 45 ditë pune. Nëse vlerësohet së duhet bërë një hetim, zyra e auditit e CAO-s kryen një hetim të hollësishëm për performancën e IFC-së/MIGA-s. Raporti i hetimit, ku përfshihet çdo gjetje për mosrespektim të stadardeve, i shoqëruar me përgjigjen e IFC-s/MIGA-s, bëhet publik.

Hapi 5: **Monitorimi dhe ndjeka e rastit**

Hapi 6: **Përfundimi/Mbyllja e rastit**

<sup>3</sup> Për më shumë detaje për rolin dhe punën e CAO-s, ju lutem referojuni versionit të plotë të Udhëzimeve Operacionale: [http://www.cao-ombudsman.org/documents/CAOOperationalGuidelines\\_2013.pdf](http://www.cao-ombudsman.org/documents/CAOOperationalGuidelines_2013.pdf)

<sup>4</sup> Kur palët e interesit nuk janë në gjendje t'i zgjidhin çështjet përmes një procesi bashkëpunues brenda një afati kohor të dakortësuar, funksioni i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve i CAO-s do të përpiqet së pari t'i ndihmojë palët e interesit për kapërcimin e ngërçit. Nëse kjo nuk është e mundur, grupi i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve do të informojë palët e interesit, përfshirë stafin e IFC/MIGA-s, Presidentin dhe Bordin e Grupit të Bankës Botërore, dhe publikun, se procesi i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve e ka mbyllur ankesën dhe e ka transferuar atë për vlerësim në funksionin e auditit të CAO-s.